



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE ✓

Nr.2980/1 prot.

Gramsh, më 17/08/2020

Lënda: Njoftim për shpallje të procedurave “lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil” në kategorinë ekzekutive (specialist), Bashkia Gramsh.

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Adresa: Bulevardi “B. Curri” pranë ish-Hotel “Arbana”

TIRANË

Bashkëlidhur Ju dërgojmë Njoftimin nr.2980, datë 17.08.2020 “Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive (specialist) për pozicionet - Inspektor tatim-taksa, Sektori i Tatim-Taksave, Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, -Specialist për emergjencat civile dhe strehim, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporte, Strehim dhe Emergjencave Civile, -Specialist i burimeve njerëzore, Sektori i Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, -Inspektor kontrolli i shërbimit të veterinarisë, Sektori i Shërbimit të Veterinarisë, kategoria V, klasa IV-a, Bashkia Gramsh.

Afati i dorëzimit të dokumenteve, vendi, data dhe ora ku do të zhvillohet konkurrimi me procedurën e “lëvizjes paralele dhe pranimi në shërbimin civil” dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve, mbeten ato të shpallura në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh (www.bashkiagramsh.gov.al), me shkresën Nr.2980, datë 17.08.2020 “Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive (specialist) në Bashkinë Gramsh.

Njoftimi i shoqëruar me shkresë për sa më sipër, do t’ju niset edhe me E-mail, në adresën: vendetelirapune@shkp.gov.al

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P/Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

Joana Zani

KRYETARI

Klodian TAÇE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 288 prot.

Gramsh, më 17/08/2020

Lloji i diplomës: “shkencat ekonomike, inxhinierike, rendit, ekonomike dhe veterinarisë”

Niveli minimal i diplomës: “Bachelor”

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(SPECIALIST)**

Në bazë të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu IV “pranimi në shërbimin civil” neni 21, neni 22, Kreu V “lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive” neni 25; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” (i ndryshuar) Kreu II dhe Kreu VII; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura (ndryshuar VKM nr.305, datë 05.04.2017); Vendmit nr.20, datë 25.02.2020 “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në Shërbimin Civil, për vitin 2020” të Këshillit Bashkiak Gramsh; Urdhërit nr.226, datë 24.07.2020 “Për shpallje vendesh të lira pune në administratën e Bashkisë Gramsh” të kryetarit të bashkisë, Njësia e Burimeve Njerëzore, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive për grupin e përgjithshëm të pozicioneve:

- Inspektor tatim-taksa terreni, Sektori i Tatim-Taksave, Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, kategoria IV, klasa IV-a;
- Specialist për emergjencat civile dhe strehim, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporte, Strehim dhe Emergjencave Civile, kategoria IV, klasa IV-a;
- Specialist i burimeve njerëzore, Sektori i Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, kategoria IV, klasa IV-a;
- Inspektor kontrolli i shërbimit të veterinarisë, Sektori i Shërbimit Veterinari, Kontrollit të Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, kategoria IV, klasa IV-a.

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**PËR TË DYJA PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË
SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për

LËVIZJE PARALELE:

27.08.2020

Afati për dorëzimin e dokumentave për

**PRANIM NË SHËRBIMIN
CIVIL:**

01.09.2020

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

1. **Specialist tatim-taksash terreni**, grumbullon informacionin e nevojshëm për vlerësimin tatimor të bizneseve ushqimore, fruta-perime, mish-bulmet...etj dhe propozon masën e tatimit për këto lloj biznesesh. Siguron regjistrin me të dhënat përkatëse për të gjithë subjektet dhe institucionet që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë, sipas ndarjes zonale për evidentimin e llojit të aktivitetit, sipërfaqet në të cilat ushtrohet aktiviteti e plotëson dosjet me të dhënat përkatëse. Kryen kontrolle në subjektet e biznesit të vogël për mbajtjen e dokumentacionit, regjistrimin e tyre në librin e qarkullimit, përdorimin e kasave fiskale e pajisjen e blerësit me kuponin tatimor.
2. **Specialist për emergjencat civile dhe strehim**, evidenton të gjitha kërkesat e familjeve të pastreha, harton statistikën në lidhje me numrin e familjeve të pastreha. Përpunon dokumentacionin e qytetarëve të pastrehë që do të kryejnë procedurat e përfitimit/privatizimit për apartamentet e financuara nga Enti Kombëtar i Banesave
3. **Specialist i burimeve njerëzore**, ndjek dhe zbaton procedurat ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me rekrutimin, vlerësimin e rezultateve në punë, regjistrin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacionet mbi indikatorët e menaxhimit të burimeve njerëzore.
4. **Inspektor kontrolli i shërbimit veterinar**, kujdeset që të gjitha produktet që tregtohen të jenë të pajisura me dokumentacionin përkatës. Kontrollon kafshën para therjes, mishin gjatë dhe pas therjes dhe bën ekspertizën veterinare të mishit. Kujdeset për dizinfektimin e ambienteve të therjes dhe tregëtimit të mishit të freskët. Kontrollon regjimin termik të frigoriferëve me kapacitet të madh dhe të dhomave frigoriferike. Të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të komunitetit të Bashkisë nga sëmundjet me origjinë shtazore (sëmundje që transmetohen nga kafsha te njeriu), nga toksinfeksionet apo infeksionet nga lëndë me elemente toksike, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm sanitaro-veterinar të produkteve me origjinë shtazore.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedure vetëm nëpunësit civil të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

1. Të jetë nëpunës i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori (ekzekutive) për të cilën aplikon;
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;
4. Të plotësojë kriteret e vecanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit **BACHELOR** -në shkencat ekonomike për pozicionin **Inspektor tatim-taksa terreni**; -në shkencat ekonomike, inxhinierike dhe rendit për pozicionin **Specialist për emergjencat civile dhe strehim**; -shkencat ekonomike për pozicionin **Specialist i burimeve njerëzore**; -shkencat e veterinarisë për pozicionin **Inspektor kontrolli i shërbimit veterinar**;
2. Të ketë deri në 1(një) vit pune në profesion;
3. Njohja e një gjuhe të vendeve të BE-së përbën avantazh;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin e lirë;
2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
4. Dëshminë e statusit të nëpunësit civil;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 27.08.2020

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **31/08/2020**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit bashkiagramsh.gov.al , **listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të**

zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”(i azhornuar);
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Kodin e Proçedurave Administrative;
- Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin 9367, datë 07.04.2005 ”Për parandalimin e konfliktit interesit(i ndryshuar);
- Ligji nr.138/2015, datë 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”
- Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .
- si dhe pyetje të tjera nga specialiteti përkatës.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën (20 pikë), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pikë), si dhe çertifikimin pozitiv (10 pikë). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në
21.09.2020

2

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e zyrtare të Bashkisë Gramsh, Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe stendën e Njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, duke filluar nga data 31/08/2020

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedure kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar).

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit nëshërbimin civil janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
7. Të plotësojë kërkesat e posacme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posacme për kategorinë, klasën grupin dhe pozicionet përkatëse;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit **BACHELOR** -në shkencat ekonomike për pozicionin **Inspektor tatim-taksa terreni**; -në shkencat ekonomike, inxhinierike dhe rendit për pozicionin **Specialist për emergjencat civile dhe strehim**; -shkencat ekonomike për pozicionin **Specialist i burimeve njerëzore**; -shkencat e veterinarisë për pozicionin **Inspektor kontrolli i shërbimit veterinar**;
2. Të ketë të paktën 1(një) vit pune në profesion;
3. Njohja e një gjuhe të vendeve të BE-së përbën avantazh.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vacant;
2. Jetëshkrim (CV) I plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates **01.09.2020***

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **08/09/2020**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nërëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të Bashkisë, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit bashkiagramsh.gov.al, **listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimi në shërbimin civil dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.** Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimi në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e vecanta, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkak të moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”(i azhornuar);
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Kodin e Proedurave Administrative;
- Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin 9367,date 07.04.2005 ”Për parandalimin e konfliktit interesit(i ndryshuar);
- Ligji nr.138/2015, date 17.12.2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”
- Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .
- si dhe pyetje të tjera nga specialiteti përkatës.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

d- Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Lista e fituesve me mbi 70(shtatëdhjetë) pikë do të shpallet në datën 30.09.2020

Njoftimi do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Afati për ankim është 5(pesë) ditë duke filluar nga data 25.09.2020.

Njësia përgjegjëse, në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues ose me më pak fitues se planifikimi, rihap procedurën e pranimit në shërbimin civil, brenda 5(pesë) ditëve kalendarike nga përfundimi i shqyrtimit të akimeve.

P/Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

Joana Zani



KRYETARI

Klodian TACE

